

Në mbështetje të Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Ligji Nr. 05/L -038, neni 14 dhe të Statutit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, nr. 446/2, të 11.05.2016, neni 30, Kuvendi i Akademisë, në mbledhjen e vet të mbajtur më 21 dhjetor 2017, nxori

RREGULLOREN

Për blerjen e veprave artistike

Neni 1

Me këtë Rregullore rregullohet mënyra e blerjes së veprave artistike për pasurimin e fondit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. (në tekstin e mëtejme Akademia).

Neni 2

1. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (në tekstin e mëtejme: Akademia) blenë vepra artistike për pasurimin e fondit të saj dhe ka për qëllim stimulimin e krijesve artistikë të Kosovës.
2. Akademia blenë vepra që kanë vlerë të veçantë artistike, të anëtarëve të saj dhe të artistëve të tjerë.
3. Anëtarëve të Akademisë me rastin e realizimit të ekspozitave që janë pjesë e Programit të punës së Akademisë, iu blihet nga një vepër artistike, pas përfundimit të ekspozitës.
4. Veprat e Fondit nuk dhurohen.

Neni 3

1. Kryesia e Akademisë cakton Komisionin për blerjen e veprave artistike në përbërje prej 5 anëtarëve dhe nga ata cakton kryetarin e Komisionit.
2. Komisioni është i pavarur në punën e tij
3. Mandati i Komisionit zgjat 4 vjet.

Neni 4

1. Mbledhjet e Komisionit i thërret dhe i kryeson kryetari i Komisionit.
2. Komisioni në mbledhje përzgjedh veprat artistike dhe cakton shumën e mjeteve financiare për secilën vepër.
3. Komisioni me shumicë votash miraton listën përfundimtare të cilën ia dërgon për miratim Kryesisë së Akademisë.

Neni 5

1. Kryesia e Akademisë merr vendim për blerjen e veprave artistike, në bazë të përzgjedhjes së Komisionit.
2. Mjetet financiare për blerjen e veprave artistike sigurohen nga buxheti i Akademisë.
3. Shuma e mjeteve financiare për blerjen e veprave artistike, përcaktohet për çdo vit me planin financiar të Akademisë.

Neni 6

Rregullorja hyn në fuqi 8 (tetë) ditë pas miratimit të saj nga Kuvendi i Akademisë.

KRYETARI I AKADEMISË

Akademik Hivzi Islami

